

Data 25.01.2023.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

«Blerje mish per vitin 2024 «.

“

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV, Mish – 15110000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

3 105 000 (tre milion e njeqind e pese mije) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Oferten ekonomike.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të paktën 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-së, për të cilin duhet të paraqitet vërtetim i leshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëq operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe nënën 64 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2020 – 2021 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit. Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nënën 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, te ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.3 Pervoja e ngjashme :

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses te nje ose disa kontrata te meparshme , të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet te jete te minimalisht deri ne 20% e vlerës te kontrates qe po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete OE duhet te paraqese si dëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara . (Per kontratat ne sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Aftesite teknike dhe profesionale

- 2.3.2. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara . (Per kontratat ne sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera një njesi tregtare në të cilin magazinon mallrat e kërkuara objekt i këtij prokurimi, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës apo marrëveshjes kuader , për të cilin duhet të paraqesë:
 - **Aktin e pronësise ose Kontraten e marrjes me qira të objektit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësise së objektit që ka pronari, i cili jep me qira.
 - **Lejen higjieno-sanitare të objektit të vlefshme** të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet përkatëse (Inspektoriat që mbulon fushën e shëndetit) ose vërtetim për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare nga organet kompetente në RSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne respektim të nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalent”.

Sqarim për ofertuesit : Në respektim dhe zbatim të **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 neni 39,** Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, date 19.05.2021, të ndryshuar. **Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë**

ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Te dhenat e mëposhteme janë përgatitur nga komisioni i perlllogaritjes se vleres se fondit limit dhe hartimit te specifikimeve teknike.(bashkangjitur DST)

Shënim : Në rastet kur citohet në specifikimet teknike termi “marke” ose “ Cilesia e pare”, ky përcaktim është i barasvlefshëm me termin “ ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT